



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 1015/3 prot

Tiranë më 18/7/2014

REKOMANDIM

Nr. 64, datë 18/7/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Ani Anitsal Yapilari Koruma Degerlendirme ve Yapim Mimarlik Restorasyon Limited Sirketi - Degë e shoqërisë së huaj".

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 94 datë 29.05.2014, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "Ani Anitsal Yapilari Koruma Degerlendirme ve Yapim Mimarlik Restorasyon Limited Sirketi - Degë e shoqërisë së huaj" me objekt:

- "Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij".

Në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, ju jeni kontrollues privat i cili kryen veprimtarinë në fushën e restaurimit të objekteve të kultit. Në kuadër të kryerjes së veprimtarisë përpunohen të dhëna personale për kategorinë punonjës të tilla si: emër, mbiemër, gjinia, mosha, datëlindja, vendlindja, atësia, adresa e banimit, numër i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, foto, numri i telefonit fiks ose celular, të dhëna shëndetësore. Këto të dhëna administrohen në dokumentet e dorëzuara nga punonjësi në kuadër të administrimit të dosjes personale që administrohet nga burimet njerëzore.

Të dhënat personale të "punonjësve" mbledhen dhe administrohen në mënyrë manuale, aksesit në këto të dhëna është i kufizuar. Të dhënat personale të "punonjësve" nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mbledhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për punonjësit lidhet me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe administrimin e marrëdhënieve të punës

Rezulton që ju si kontrollues nuk keni kryer detyrimin për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Në njoftim duhet të deklaroni nëse përpunimi i të dhënave

bëhet për një qëllim apo për disa qëllime, një përshkrim i përgjithshëm i masave për sigurinë e të dhënave personale, nëse janë hartuar, miratuar dhe zbatohen rregulla konkrete të cilat bëjnë të mundur përpunimin e sigurve dhe të ligjshëm të të dhënave personale. Rëndësi të veçantë ka caktimi i një oficeri (*ose personi të ngarkuar*) sipas nenit 3/14 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesit, si dhe regjistrimi i tij pranë KMDP, pasi shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale.

Në kuadër të transparencës, një nga parimet bazë të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar është informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit si një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale. Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Nga ana juaj si kontrollues nuk zbatohen praktika për të informuar punonjësit për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur ku të përfshihen mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtja e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Rezulton gjithashtu se nuk keni hartuar rregulla lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, prandaj në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, ju si kontrollues i të dhënave personale keni detyrimin të hartoni rregullore të brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Hartimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Sa më sipër;

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të merren masa për informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, sigurinë e të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.

2. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave personale*" i ndryshuar, të realizohet detyrimi për njoftim pranë Autoritetit së Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale nga ju si kontrollues. Informacione të rëndësishme

lidhur me njoftimin mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

